



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK

PROTOKOLLI 3

REND-DITE

1. Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.
2. **Projekt-Vendim** “Për një ndryshim në vendimin nr.133 datë 27.11.2025 për miratimin e themelimit të shoqërisë tregtare "Green Kolonja" sh.a, si person juridik ne pronësi të bashkisë Kolonjë dhe miratimin e akteve të themelimit"
3. **Projekt-Vendim** “Për rishqyrtimin e vendimit nr.27 datë 13.02.2026 “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026.”
4. **Projekt-Vendim** “Për rishqyrtimin e vendimit nr.28 datë 13.02.2026 “Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore “Në vendimin nr.152, datë 22.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026.”

Protokolli i mbajtur sot më datë 20.02.2026 në mbledhjen e jashtë rradhe sipas njoftimit të dhënë në datën 19.02.2026.

Të pranishëm: S. Rexhepi, E. Xhelili, B.Jashari ,I.Milo, G.Tafili, P.Çunge, Z.Meto, S.Kodra, E.Avdi, E.Çikopana.

Mungon: A.Tartari, , T.Çaçani, S.Larti, H.Iljazi, A.Zeneli, I.Hodo.

E. Xhelili: Përshëndetje, fillojmë me mbledhjen e datës 20.02.2026 pika e parë e rendit të ditës. Jeni dakort me rendin e ditës?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Ka dikush prej jush konflikt interesi me ndonjë nga pikat e rendit të ditës?

E. Xhelili: Nuk ka asnjë konflikt interesi.

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën dy të rendit të ditës “Për një ndryshim në vendimin nr.133 datë 27.11.2025 për miratimin e themelimit të shoqërisë tregtare "Green Kolonja" sh.a, si person juridik ne pronësi të bashkisë Kolonjë dhe miratimin e akteve të themelimit"

S.Rexhepi: Në mbledhjen e datës 27.11.2025 është marrë vendimi numër 133 për miratimin e themelimit të shoqërisë tregtare "Green Kolonja" sh.a, si person juridik ne pronësi të bashkisë Kolonjë dhe miratimin e akteve të themelimit. Në mbledhjen e kaluar të datës 13.02.2026 është marr vendimi nr.27 datë 13.02.2026 “Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026, dhe vendimit nr.28 datë 13.02.2026 Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 dhe Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore “Në vendimin nr.152, datë

22.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 për të miratuar vlerën e hapjes së shoqërisë tregëtare "Green Kolonja". Kapitali fillestar për hapjen e një shoqërie tregëtare është jo më pak se 3.500.000 lek . Vlera që duhet të ishte 5.000.000 lek si pasojë e një gabimi drejtshkrimor është bërë 500.000 lek.

P.Çunge: Ndryshimi i vetëm është vlera nga 500.000 lek në 5.000.000 lek.

E.Xhelili: Jeni dakord me projekt-vendimin?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën tre të rendit të ditës "Për rishqyrtimin e vendimit nr.27 datë 13.02.2026 "Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026."

Z. Meto: Është e qartë pse nuk është bërë miratimi i dy vendimeve pasardhëse si pasojë e gabimit në vlerë të shumës.

E. Xhelili: Jeni dakord me projekt-vendimin?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën katër të rendit të ditës "Për rishqyrtimin e vendimit nr.28 datë 13.02.2026 "Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore "Në vendimin nr.152, datë 22.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026."

E.Xhelili: Jeni dakord me projekt-vendimin?

Pro 9 Kundër 0 Miratohet

Proces-Verbali i datë 20.02.2026 është firmosur nga 10 anëtarë Këshilli.

SEKRETAR I KËSHILLIT
INSUIDA ORHANAS



KRYETAR I KËSHILLIT

ERALDO XHELILI

